

Joseph Kessel

Luani

Roman

Përktheu: Ivana TOMÇO

Titulli i origjinalit: Le lion

© Editions Gallimard, 1958

Redaktorë:

Sejdin ÇEKANI

Artan MIRAKA

PJESA E PARË

Kapitulli I

Mos ndoshta donte të shihte se ç'fshihej nën qepallat e mia? S'isha i sigurt.

Kur po më dilte gjumi, m'u bë sikur nëpër fytyrë po shëtiste një furçë e lehtë dhe e ashpër, por ngaqë u zgjova, pashë se te koka e jastëkut ishte ulur dikush që m'i kishte qepur sytë e s'm'i ndante.

Trupi i tij nuk i kalonte përmasat e një arre kokosi. Atë ngjyrë kishte edhe gëzofi i tij i shkurtër. I veshur asisoj, nga gishtat e këmbës te maja e kokës, dukej si një topth pelushi. Vetëm turirin dukej sikur e kishte të mbuluar me një gjysmë maske prej atllasi të zi, dhe përmes saj sytë shkëlqenin si dy pika.

Dita mezi po zbardhte, por drita e llambës, që përdorej kur kishte furtunë e që, nga lodhja e tepërt kisha harruar ta fikja, më mjaftonte për të dalluar qartë në sfondin e bardhë të mureve të lyera me gëlqere këtë misionar të jashtëzakonshëm të agimit.

Disa orë më vonë, prania e tij do të më ishte dukur ndryshe. Fisi i tij jetonte

nëpër pemët e larta përreth kasolles sime. Familje të tëra lodronin mbi një degë të vetme. Një mbrëmje më parë isha kthyer vonë dhe isha i rraskapitur, ndaj mbeta pa frymë kur pashë majmunin e vockël, që rrinte aq pranë fytyrës sime.

Ai nuk lëvizte fare. Madje nuk i lëviznin as pikat e zeza në gjysmëmashkën prej atllasi të zi.

Në atë vështrim përziheshin frika, mosbesimi dhe kureshtja. Me sa dukej, po më studionte me vëmendje.

Më pas koka e tij e pelushtë, sa grushti i një foshnjeje në djep, u kthye nga e majta. Sytë e zgjuar më shihnin me një shprehje trishtimi dhe mëshire.

Dukej sikur donte të thoshte se më donte të mirën dhe po përpiquej të më jepte një këshillë. Po çfarë?

Padashur, bëra një lëvizje. Topthi i vogël i praruar bojëkafe fluturoi deri te dritarja e hapur dhe u zhduk në mjegullën e mëngjesit.

Rrobat e mia ndodheshin përtokë, te koka e shtratit, siç i kisha hedhur mbrëmë kur kisha rënë për të fjetur, pranë llambës së furtunës.

U vesha dhe shkova në verandë.

M'u kujtua se në mbrëmje, me gjithë errësirën e madhe, kisha vënë re se kasollen time e rrethonin grumbuj shkurresh dhe, para tyre, një lirishtë që zhytej në fshehtësitë e natës. Por ndërkaq gjithçka ishte mbuluar nga mjegulla. Shihja vetëm majën më të lartë të botës, Kilimanxharon, si një tryezë gjigante të stolitur nga dëborërat e përjetshme.

Kur po ngjisja shkallët prej druri të virgjër, që të shpinin në verandë, më tërhoqi vëmendjen një zhurmë e ngjashme me një rrotullim të shpejtë zares. Dalëngadalë, pa e prishur terezinë, në fund të shkallës po kacavarej një gazelë, një gazelë e vërtetë, por shumë e vogël, aq sa veshët e saj s'arrinin as deri te gjunjët e mi.

Krijesa e mrekullueshme që doli nga mjegulla, ndaloi te këmbët e mia dhe ngriti

turirin. U ula dhe zgjata dorën ngadalë drejt kokës së saj, që dukej si e gdhendur me finesë. Gazela nuk luajti. I preka flegrat; ia përkëdhela.

Qëndronte pa lëvizur e më vështronte. Ai vështrim i dhembshur më kujtoi vështrimin e majmunit të vockël melankolik. Por, as kësaj here, s'kuptova gjë.

Si për të më kërkuar të falur që s'mundej të fliste, më lëpiu gishtat. Pastaj e largoi turirin ngadalë. Putrat e saj bënë përsëri nëpër shkallë atë zhurmën e rrotullimit të zareve. Pastaj u zhduk.

Mbeta prapë vetëm. Agimi tropikal ishte shumë i shkurtër. Po lindte dielli. Nga gjiri i errësirës po triumfonte drita. Gjithçka shkëlqente: dëborërat e Kilimanxharos, që dukeshin sikur i përshkonin shigjeta të kuqe alle; shtëllungat e mjegullës, që nga rrezet e para të diellit të agimit po shprisheshin, po shpërndareshin në formë vellosh, spiralesh, tymrash, që ngjanin si pluhur diamanti; bari i thatë, zakonisht i ashpër dhe i verdhë, por që tani shndriste nga vesa dhe dukej i njomë.

Në pemët me gjembaçë të shndritshëm, rreth e qark kasolles sime, këndonin zogjtë dhe turtullitnin majmunët.

Mjegulla para verandës po davaritej dalëngadalë, duke i lënë vendin një hapësire të gjelbër, të madhe e të mistershme, në fund të së cilës lëkundeshin ca re të tjera, që më pas edhe ato fluturonin.

Perde pas perdeje, toka po hapte siparin e teatrit të saj në botë për lojërat e ditës.

Andej nga fundi i lirishtës pashë një vezullimë uji... Liqen? Pellg? Apo kënetë? As njëra dhe as tjetra, por mbase hapësira e ujit ushqehet nga ndonjë burim i nëndheshëm. E pafuqishme të përhapej më tej, syprina e ujërave dridhej mes barërave të gjatë, kallamave dhe shkurreve të dendura.

Pranë ujit kishte kafshë.

Shumë prej tyre i kisha parë përgjatë rrugëve dhe luginave - në Tanganikë, Uganda e Kenia - gjatë udhëtimit për në Afrikën e Jugut, nga i cili sapo isha

kthyer. Por ato ishin veçse vegime të mjegullta e fluturake hordhish që shpërndareshin nga zhurma e makinave, silueta të shpejta, të trembura e të zalisura.

Ndonjëherë, për pak kohë, kisha fatin të përgjoja ndonjë kafshë të egër, pa u vënë re prej saj; këtë e bëja vetëm nga larg dhe fshehurazi, domethënë në mënyrë dredharake.

Pozicionet që merrnin ato jetë të lira e të pastra në thatësinë e xhunglës, i kundroja me një ndjenjë të veçantë pangopësie, entuziazmi, zilie dhe dëshpërimi. Më dukej sikur kisha gjetur një parajsë të njohur e të ëndërruar të një moshe që s'e mbaja më mend. Isha i aftë të shkoja deri në pragun e saj, por s'mundja ta kapërceja.

Takime të njëpasnjëshme, dëshira që ndiqnin njëra-tjetrën, derisa më në fund kishte ardhur një çast ku ndieja një nevojë, sigurisht foshnjake, po gjithnjë e më të paduruar, për ta parë veten edhe njëherë në çastet e pafajshme të fillimeve të botës.

Para se të kthehesha përsëri në Europë, kisha vendosur të kaloja nëpër të gjitha parqet mbretërore të Kenias, në rezervatet ku jeta e kafshëve të egra mbrohet me ligje jashtëzakonisht të rrepta.

Dhe ja ku ishin!

Tashmë ato s'ndiheshin më të alarmuara dhe ishin mbledhur në tufa jo për shkak të frikës a mosbesimit; ishin grumbulluar në varganë sipas racës, fisit, apo familjes, duke u përzierë me njëra-tjetrën në kushtet e një sigurie të jashtëzakonshme dhe ndiheshin në paqe me bimësinë, sa herë që zbardhte agimi. Që aty ku ndodhesha, s'e dalloja dot kahun e lëvizjeve apo harmoninë e ngjyrave, por gjithsesi, edhe pse nga larg, arrija të shihja mizërinë e kafshëve që ishin me qindra e mijëra. Të gjitha speciet rrinin pranë njëra-tjetrës dhe, në atë çast të jetës së tyre, ato s'e njihnin as frikën dhe as hutimin.

Gazela, antilopa, gjirafa, zebra, rinoqerontë, elefantë, buaj; kafshët ndaleshin ose zhvendoseshin si t'u donte qejfi apo si ta sillte rasti; ose nga t'i shpinte uria.

Dielli, ende i butë, rrëshqiste ngadalë mbi vendet me dëborë në majë të Kilimanxharos. Flladi i mëngjesit luante me flokëzat e fundit të dëborës që po i treste mjegulla.

Korijet dhe livadhet e mbushura me kafshë me brirë të praruar, të drejtë, me majë apo të përkulur, formonin një tapiceri gjigante, që varej faqeve të malit të madh të Afrikës.

S'mbaj mend se kur dhe se qysh u largova nga veranda. S'isha më në vete. Më dukej sikur kafshët më thërritnin drejt një lumturie që kish ekzistuar para se të vinin kohërat e njeriut.

Eca përpara në shtegun anës shkurreve, përgjatë një rreshti pemësh. Ardhja ime, në vend që ta prishte prehjen e asaj bote përrallore zanash, u duk sikur e pasuroi më tepër dhe i dha më shumë kuptim.

Në çdo hap që hidhja, e kuptoja më mirë llojin e familjeve, finesën dhe forcën e tyre. Dalloja veshjen e antilopave, ballin e tmerrshëm të buajve, masivet si prej graniti të elefantëve.

Kafshët kullotnin, pinin ujë, endeshin nga njëra tufë në tjetrën, nga njëri pellg në tjetrin. Ato ishin të qeta në mbretërinë e tyre, që sa vinte e bëhej gjithnjë edhe më reale, gjithnjë edhe më e prekshme. Vazhdova të ecja.

Kisha mbërritur në fundin e shkurreve. Ndërkaq s'më mbetej veçse të dilja prej strehës së tyre dhe të prekja tokën e lagësht e të shndritshme, ku do të mund të njihja miqësinë e kafshëve të egra pikërisht në territorin e tyre.

S'mund të më pengonte më asgjë.

Reflekset e vetëkujdesjes më ishin topitur dhe mbi mua po fitonte një instinkt tjetër edhe i më i fortë, që më shtynte të bëja përpara drejt gjithësisë.

Dhe, më në fund, ai triumfoi.

Por, në atë çast, diçka alarmuese më bëri të ndalesha. Ndjeva praninë e dikujt tjetër. S'ishte kafshë. Tashmë më dukej sikur unë i përkisja botës së tyre. Ishte qenie njerëzore

Dëgjova dikë të më thoshte anglisht:

- S'mund të shkoni më tutje!

Më ndanin vetëm dy-tri hapa nga një siluetë e brishtë, nën hijen e një shkurreje gjigante. S'kishte ndërmend të fshihej.

Por, ngaqë nuk lëvizte fare dhe kishte veshur ca kominoshe bojë hiri, dukej si zgjatim i trungut ku ishte mbështetur.

Kisha përballë një fëmijë rreth dymbëdhjetëvjeç, me kokë të zbuluar. Një balluke flokësh të zinj e të ndarë në mes i mbulonte ballin. Fytyrën e kishte rrumbullake, tepër të lëmuar, dhe qafën të gjatë. Sytë e mëdhenj bojëkafe dukeshin sikur nuk më shihnin mua, por kafshët, ndërsa qepallat nuk i lëvizte fare.

U ndjeva në siklet që një fëmijë më zuri gafil në atë çast, kur ndihesha më fëmijë se ai.

E pyeta me zë të ulët:

- E pse s'mund të shkoj më tej? Mos është gjë e ndaluar?

Koka me balluket e krehura përpjetë pohoi me të shpejtë, pa i hequr sytë nga kafshët.

E pyeta prapë:

- E sigurt?

- E kush mund ta dijë më mirë se unë? - tha fëmija. - Im atë është administratori i Parkut Mbretëror.

- Aha, tani e kuptova! - i thashë. - Dhe ka ngarkuar të birin të vëzhgojë.

Në atë çast, sytë e mëdhenj më vështruan për herë të parë. Fytyra e zeshkët mori një shprehje që i shkonte moshës së tij.

- E keni gabim, - tha fëmija me kominoshe gri. - Unë s'jam djalë, por vajzë. Më

quajnë Patricia.

Kapitulli II

Nuk ishte hera e parë që Patricia e habiste ashtu një vizitor. S'ishte e vështirë ta kuptoje, mjaft të shihje fytyrën e saj dinake.

Veç kësaj, ajo kishte një shprehje aq naive e fëmijërore në fytyrë, sa të joshte e të bënte për vete. M'u desh të shkundesha nga ëndërrimet për të kuptuar se atë mëngjes ndodhesha disa hapa larg kafshëve, në mes të shkurreve, i vetëm me një vajzë të vogël.

- Si të lënë të dalësh kaq herët dhe të shkosh kaq larg? - i thashë.

Patricia nuk u përgjigj. Tiparet e palëvizshme dhe serioze të fytyrës të bënin përsëri të mendoje se ishte djalë. Vazhdonte të vështronte tufat e egra, sikur unë të mos isha fare aty.

Ndërkaq drita e agimit po bëhej e gjithëpushtetshme. Kafshët përreth ujit, ku pasqyrohej dielli, po shtoheshin.

Ndjeva të më pushtonte përsëri ajo dëshira e fortë që më kishte çuar aty. Dhe s'mund të kthehesha pikërisht nga një vajzë e vogël. Bëra një hap drejt lirishtës.

Patricia, pa e kthyer kokën, tha:

- Mos shkoni atje!

- Mos ke ndërmend të thërrasësh babin që të më përzërë nga Parku? - e pyeta.

- Unë s'jam spiune! - tha Patricia.

Në vështrimin e saj dallohej sinqeriteti i fëmijës.

- Atëherë paske frikë se mos më ndodh gjësendi mua? - i thashë.

- Ju jeni i rritur dhe kujdeseni vetë për veten. Pastaj, aq më bën, edhe po t'ju ndodhë gjësendi! - tha Patricia.

Si ishte e mundur që një fytyrë aq e njomë dhe e freskët të mund të arrinte deri

në atë pikë, pra të tregohej mospërfillëse deri në mizori? Vërtet nuk donte t'ia dinte se ç'mund të më bënin thundrat dhe brirët e kafshëve? S'do t'i bënte përshtypje fare po të më shihte të shkallmuar e të shkelur me këmbë?

- Po atëherë... atëherë, si e ke hallin?

- S'është e vështirë ta kuptosh, - tha Patricia. Naiviteti im po fillonte ta acaronte. Sytë e zinj iu përshkënditën. - Nuk e shihni se sa të qeta janë kafshët dhe se sa mirë ndihen me njëra-tjetrën? Ky është çasti më i bukur i ditës së tyre.

Ajo dukej sikur zotëronte një pushtet të jashtëzakonshëm. Apo ndoshta më bëhej mua ashtu, për shkak të orës e të peizazhit? Herë-herë, ajo dukej sikur ndihej plotësisht e sigurt dhe sikur dinte gjëra që s'kishin të bënin fare me moshën e saj. Dukej sikur jetonte jashtë botës së njerëzve.

- S'kam ndërmend t'i shqetësoj kafshët, - i thashë. - Thjesht dua të jem pranë tyre. Patricia më hetoi gjithë dyshim.

- Vërtet i doni? - më pyeti.

- Besoj se po.

Sytë e mëdhenj qëndruan gjatë pa lëvizur. Pastaj, në fytyrën e saj të ndjeshme u ravijëzua një buzëqeshje mirëbesimi.

- Edhe unë, - tha.

E kam të vështirë ta përshkruaj gëzimin që më shkaktoi buzëqeshja dhe përgjigja e saj.

- Atëherë, a mund të shkoj? - e pyeta.

- Jo, - tha Patricia.

Koka me balluket e ndara me vijë në mes bëri një shenjë të lehtë mohimi.

- Pse? - e pyeta.

Patricia s'u përgjigj menjëherë. Vazhdonte të më vështronte e heshtur dhe e menduar. Por vështrimi i saj ndërkaq dukej më miqësor. Veçse miqësia e saj ishte krejt e veçantë: e shkujdesur dhe melankolike, me një vështrim të pafajshëm që të

prekte, ku ndihej pafuqia për të të ndihmuar.

M'u bë sikur e kisha parë edhe më parë atë vështrim. Ku? M'u kujtua përnjëherësh majmuni dhe gazela e vockël, që më kishin vizituar në kasollen time. Trishtimin e mistershëm të vështrimit të tyre po e shihja te Patricia, në sytë e saj të mëdhenj dhe të zinj. Por, ndryshe nga ata, vajza e vogël ishte në gjendje të fliste.

- Kafshët nuk ju duan juve, - tha më në fund Patricia. - Po t'ju shohin, ato s'mund të dëfrehen të qeta e të lira si t'ua dojë qejfi, ashtu siç janë mësuar.

- Po unë i dua, - i thashë. - Edhe ti je e sigurt për këtë.

- E ç'rëndësi ka? - u gjegj Patricia. - Kafshët s'janë për ju. Ju duhej ta dinit mirë këtë, por në të vërtetë s'keni si ta dini... S'mundeni. - U përpoq për një çast të shpjegonte diçka, por pastaj ngriti lehtë supet e dobët dhe shtoi: - Ju vini nga larg dhe tani është vonë.

Patricia u mbështet pas shkurres së madhe. Mezi dallohej, sepse ngjyrat e pemës ishin të njëjta me ngjyrën e rrobave që mbante veshur.

Drita depërtonte edhe më thellë nëpër shkurre. Prej tyre dilnin familje të reja kafshësh të egra, që shkonin drejt ujit dhe barit.

Për të mos shqetësuar kafshët e tjera që ndodheshin aty, të sapoardhurit shpërndaheshin nëpër kufijtë e lirishtës. Kishte edhe nga ato kafshë që guxonin të vinin deri te shkurnaja pas së cilës qëndronim unë dhe Patricia. Por edhe ato më dukeshin të ndaluara dhe të paarrtshme, sikur livadhet ku kullosnin të kishin qenë te xhepat me borë të përjetshme në kreshtat e Kilimanxharos, në horizontin e qiellit, prej nga kishte ardhur mëngjesi i botës.

- Nga larg... nga shumë larg! - përsëriti vajza e vogël.

S'mundja ta kundërshtoja vogëlushen, sepse, ndërsa fliste, sytë i morën po atë shprehje që kishte pasur vështrimi i butë i gazelës, apo majmunit të vockël.

Papritur ndjeva mbi dorën time atë të Patricias dhe u drodha, sepse ajo më ishte

afruar pa u ndjerë. Majat e flokëve të saj më mbërrinin deri te supi, dhe ajo dukej tepër e dobët në krahasim me trupin tim. Megjithatë, në gishtërinjtë e hollë e gjithë të çara, që më shtrëngonin grushtin, ndjeva dëshirën e saj për të më mbrojtur, apo për të më ngushëlluar. Pastaj, sikur unë të isha fëmijë e ajo po përpiquej të më qetësonte, Patricia më tha:

- Ndoshta më vonë do t'ju çoj në ndonjë vend tjetër. Atje ju premtoj se do të ndiheni i kënaqur.

Vetëm atëherë vura re mënyrën e veçantë se si fliste Patricia. Deri në atë çast, ajo më kishte shtangur me sjelljen e saj të çuditshme. Por ndërkaq vura re edhe se vajza e vogël fliste pa zë, si ata të burgosurit që s'duan t'i dëgjojë njeri kur flasin mes tyre. Ndjeva se, pa e kuptuar, kisha filluar edhe unë të flisja si ajo.

- E shoh se ti qenke mike e kafshëve të egra, - i thashë.

Gishtërinjtë fëmijërorë që më shtrëngonin dorën u drodhën nga gëzimi. Dora e saj ishte ajo e një vogëlusheje të lumtur. Fytyra e kthyer nga unë, shndriti nga lumturia.

- E dini? - tha Patricia dhe fytyra iu bë lulëkuqe nga kënaqësia e zëri prapë mezi i dëgjohej. - E dini që im atë thotë se unë merrem vesh me kafshët më mirë se ai? Dhe ai i njeh shumë mirë, sepse ka jetuar gjithë jetën me to në Kenia, Ugandë, Tanganikë dhe në Rodezi. Thotë se me mua është ndryshe... Po, po, ndryshe.

Patricia tundi kokën dhe ballukja e prerë shkurt iu ngrit pak, duke i zbuluar pjesën e sipërme të ballit, që ishte më e butë dhe më e bardhë. Vështrimi i vogëlushes ra mbi dorën time, atje ku kishte vënë dorën e saj me thonj të thyer dhe me ca njolla balte të tharë.

- Ju s'jeni gjuetar, - tha.

- Ashtu është. Po ti, nga e di?

- Mua nuk më shpëton asgjë këtu, - tha vajza duke më shkelur syrin.

- Por unë deri tani s'kam folur me askënd dhe s'më ka parë askush, - i thashë.

- Askush? – ia bëri Patricia. - Po Taku, sekretari, që ju regjistroi mbrëmë? Po Maça, ai djali që ju mbajti bagazhet? Po Avori, fshesari që kujdeset për kasollen tënde?

- Këta zezakë as që e kanë idenë se çfarë bëj unë, - ia ktheva.

Në fytyrën e Patricias u shfaq përsëri ajo shprehja dinake fëmijërore, si në çastin që më kishte bërë të ditur se ishte vajzë.

- Po shoferi juaj? - tha. - E harruat atë?

- Kë, Bogon?

- Ai ju njih mirë, - tha Patricia. - A nuk të shëtiti ai gjithandej, që prej dy muajsh, me makinën që morët me qira në Najrobi?

- S'besoj t'ju ketë treguar ndonjë gjë të madhe, - shtova unë. - S'ka njeri më të mbyllur se ai.

- Ndoshta, kur flet anglisht, - tha Patricia.

- Doni të thoni se...

- S'do mend. Unë e njoh gjuhën *kikuyu* njëlloj si ai, - më shpjegoi ajo, - sepse kur isha e vogël, shërbyesja jonë ishte kikuju. Përveç saj, unë di edhe gjuhën *suahili*, sepse atë e kuptojnë vendasit e të gjitha racave. Di edhe *uakamba*, ngaqë shoqëruesi i babait tim është prej andej. Po ashtu di edhe *masaj*, sepse këta të fundit kanë të drejtë të hyjnë dhe të qëndrojnë në këtë rezervat.

Patricia vazhdonte të buzëqeshte, por tashmë me një shprehje tallëse në fytyrë dhe duke e mbajtur veten si më të mençur nga unë.

Tek ajo ishte kthyer përsëri qetësia dhe siguria, apo aftësia e saj e veçantë për të komunikuar edhe me qeniet më primitive, sipas zakoneve apo ligjeve të tyre.

- Zezakët e këtushëm s'lënë gjë pa më treguar, - foli sërish Patricia. - Unë e di se si i kanë punët; madje më mirë nga im atë. Ai di të flasë vetëm në gjuhën *suahili*, por edhe atë e shqipton si të bardhët. Pastaj ai është shumë i rreptë. Por,

tekefundit, ky është zanati i tij. Ndërkaq unë nuk spiunoj kurrë. Nëpunësit, rojet, shërbëtorët, të gjithë e dinë mirë këtë. Prandaj hapen pa frikë me mua. Taku, sekretari, më tha se pasaporta juaj është franceze dhe se ju banoni në Paris. Djali i bagazheve më tha se valixhja jote ishte shumë e rëndë, nga që kishte brenda libra. Ndërsa djali i kasolles më tha: "I bardhi s'pranoi t'ia ngrohja ujin për të bërë banjë dhe s'hëngri asgjë para se të flinte. Aq i lodhur ishte."

- Dhe kushedi se sa do të kisha fjetur, - i thashë, - po të mos më kishte zgjuar një vizitor. Por, mbase edhe ai ka ardhur tek ti dhe t'i ka thënë të gjitha.

I tregova Patricias për majmunin dhe gazelën e vockël.

- Ah, po, Nikolasi me Simbelinën! - saktësoi ajo.

Në vështrimin e saj kishte dashuri, por nuk e dha veten.

- Ata janë të mitë, - shtoi. - Por ndonjëherë afrohen edhe me të tjerët dhe i lenë t'i përkëdhelin, si të ishin qen ose mace.

- Ah, ashtu? - thashë.

S'më pëlqeu kur foli ashtu për dy vizitorët e mi të parë të mëngjesit.

- E po, me ato aty nuk është e njëjta gjë, - tha vajza e vogël dhe zgjati dorën nga kafshët e mbledhura në livadh dhe përreth rezervuarit që ushqehet nga dëborërat e malit të stërmadh. Dora e Patricias dridhej, po ashtu edhe zëri i saj që s'kishte timbër. Papritur, ajo shpërtheu e emocionuar: - Këto kafshë nuk i përkasin askujt dhe nuk marrin urdhra nga kurrkush. Edhe kur të presin në gjirin e tyre, prapë vazhdojnë të jenë të lira. Që t'i kuptosh ato, duhet të njohësh erën, diellin, kullotat, shijen e barërave dhe atë të pikave të ujit. Duhet të nuhasësh humorin e tyre, duhet të dish mirë kohën e martesave, apo të mbrosh të vegjlit e tyre. Duhet të dish të heshtësh, të dëfresh, të vraposh dhe të marrësh frymë njëlloj si ato.

- Babai jua ka mësuar të gjitha këto? - e pyeta.

- Ai nuk di as gjysmën e atyre që di unë, - u gjegj Patricia. - Nuk i del koha. Por unë i kam mësuar vetë, vetëm fare... - Patricia ngriti sytë nga unë dhe në fytyrën

e saj të vockël të nxirë nga dielli, kokëfortë dhe krenare, dallova një grimasë ngurrimi. - Më thuaj... më thuaj të vërtetën... a të shqetësoj nëse vazhdoj të flas për kafshët? - Kur pa që unë u habita, shtoi me të shpejtë: - Mami më thotë se të rriturit s'kanë nge të dëgjojnë historitë e mia.

- Ndërsa unë do të rrija gjithë ditën duke i dëgjuar - iu përgjigja.

- Vërtet?!

Ngazëllimi i saj më habiti aq shumë sa desh m'u morën mendtë. Ma mbërtheu dorën me forcë. Gishtërinjtë dukeshin sikur i digjeshin nga ethet. Ndjeva thonjtë e thyer e të dhëmbëzuar në lëkurë. "Shenja të tilla, - mendova, - tregojnë se fëmija vuan dhe se ka nevojë për diçka që s'i plotësohet. Mos ndoshta Patricia ishte e detyruar t'i paguante ëndrrat e saj me çmimin dhe peshën e rëndë të vetmisë?"

Tanimë vogëlushja kishte filluar ta ngrinte zërin. E megjithatë, ai vazhdonte të ishte i mbytur, si jehona në mjegull.

Në zërin e saj mishëroheshin përpjekjet e saj për të depërtuar në mister, gjëja e vetme që kishte rëndësi për të. Misteri i krijimit dhe i krijesës. Ajo ishte e aftë të qetësonte turbullimin dhe ankthin, njëlloj siç bëjnë barërat e lartë apo gëmushat e egra që murmurijnë nga flladi i erës.

Ai zë nuk kishte vlera për interesat e ngushta dhe të kota të njerëzve. Ai kishte aftësinë të vendoste lidhje mes mjerimit të burgut të tyre të brendshëm dhe kësaj mbretërie me të vërtetë të lirë pafajësie, që shpalohej në mëngjesin afrikan.

Në çfarë hulumtimesh të pareshtura apo intimitetesh të fshehta e kishte përfituar Patricia gjithë këtë përvojë? Tufat e atyre kafshëve, që për të tjerët ishin të ndaluara, për të ishin bërë diçka familjare. I njihnte të gjitha klanet e tyre dhe personazhet. Aty ishin zakonet e saj, armiqtë apo miqtë e saj.

Bualli që vërtitej në oazin e ujit para nesh, kishte një karakter të mbrapshtë. Elefantit plak, me dhëmbët e thyer, i pëlqente të dëfrehej si të ishte vogëlushi i

hordhisë. Por femra e tij trupmadhe, ngjyrë hiri në të zezë, në atë çast po shtynte me feçkë të vegjlit e saj drejt ujit. Ndjenja e pronës tashmë po i kthehej në mani.

Për antilopat e vogla, me brirët si turjelë, të guximshme edhe pse të brishta, Patricia ishte mikështa e luftëtarëve.

Njëerën nga zebrat e kishte parë njëherë të shpëtonte nga zjarri që morën shkurret. Të gjithë e njihnin nga shenjat që i kishte lënë zjarri.

Njëherë tjetër i kishte rastisur të shihte një betejë rinoqerontësh; dhe, pikërisht, mashkulli i bëshëm që qëndronte pa lëvizur përpara nesh, me brirët drejtuar nga qielli, si një monstër parahistorike, kishte qenë fitimtari. Që atëherë, atij i kishte mbetur ajo shenja e frikshme, e gjatë dhe e thellë, që i zbulohesh sa herë që mbi kurrizin e tij fluturonin luzma shakulluese kaçirubesh të bardha, si zogj-pilotë.

Edhe gjirafat kishin kronikën e tyre. Edhe gamilet gungaçe, të rriturit, të vegjlit, brez pas brezi.

Lojëra, luftëra, emigrime, dashuri.

Sa herë që i kujtoj këto ngjarje, unë gjithsesi arrij të krijoj rendin e tyre dhe vazhdimësinë, duke vënë rregull në to. Por Patricia i tregonte të gjitha njëherësh, pa asnjë lloj rregulli logjik. E linte veten nën ndikimin e çastit, asociacioneve primitive, frymëzimeve të shqisave dhe instinktit. Siç bënin qeniet e thjeshta e të bukura që kishim para syve, të cilat nuk e jetonin jetën me ankth, si njerëzit, sepse asnjëherë nuk bënin përpjekje të pakuptimta për të matur kohën, që nga lindja e tyre. Ato jetonin dhe vdisnin, dhe asnjëherë nuk e vrisnin mendjen dhe të pyesnin "pse".

Kështu para meje u shfaq si një pyll i thellë, ku depërtonte papritmas dielli, dendësia e kulluar e jetës shtazore.

Shihja se si agimi kishte tërhequr nga strehëzat mbrëmësore secilin prej këtyre fiseve drejt vendeve ku duhej të shkonin, dhe pastaj të shpërndareshin. Shihja fushat, kodrinat, pyllnajat, zabelet, savanën e rezervatit të madh ku kisha kaluar

një natë më parë, e që ndërkaq po bëhej territori, streha, atdheu i çdo specijeje dhe familjeje.

Diku shihja se si kërcenin antilopat, dhe në një vend tjetër elefantët.

Papritur, m'u kujtua se këtij populli i mungonte një klan dhe, padyshim, më i bukuri.

- Po lakuriqët? - e pyeta Patrician.

Pyetja ime nuk e çuditi. Madje m'u duk sikur atë po priste.

E ndjeva që ndërkaq kishim mbërritur në një shkallë të atillë mirëkuptimi, sa ndryshimi i moshës sonë s'kishte më pikë rëndësie. Çiltërsia, interesat dhe nevojat tona të përbashkëta, bënë të mundur që, me ndërmjetësinë e kafshëve të egra, të vendosej bashkëfajësia dhe barazia midis një fëmije dhe një të rrituri, që s'mbahej mend se që prej sa kohësh kishte qenë e tillë.

Vogëlushja mbylli sytë. Buzëqeshi me vete, ashtu siç bëjnë shpesh fytyrat e vogla kur flenë. Buzëqeshja e saj dukej sikur ushqehej nga një lumturi e brendshme e mistershme, që dukej sikur ia ndriçonte tiparet Patricias. Pastaj ajo çeli përsëri sytë dhe një pjesë e asaj buzëqeshje ishte pa dyshim për mua. Ishte si një lloj premtimi a marrëveshjeje midis nesh.

- Do t'ju çoj aty ku duhet, - tha Patricia.

- Kur?

- Mos u tregoni kaq i paduruar, - u përgjigj me ëmbëlsi vogëlushja. - Me kafshët duhet shumë durim. Ato kanë kohën e tyre.

- Por...

S'munda të vazhdoja. Dora e Patricias, që deri tani më kishte falur aq shumë siguri, u tërhoq me një lëvizje të papritur e të vrazhdë. Mes syve të mëdhenj e të errët, që papritur dukeshin sikur s'kishin më asnjë lloj shprehjeje, dallohej një vijë që dukej si rrudhë e parakohshme.

- Po ju sikur do të largoheshit sa më shpejt që këtej, apo jo?- pyeti vajza.

Vështrimi i saj më detyroi të mos tregoja të vërtetën.

- Nuk e di... - thashë.

- Gënjeshtar! Ju e dini shumë mirë. Keni njoftuar në recepsion se nesër do të largoheni nga Parku.

Rrudha midis dy vetullave u bë më e thekshme.

- Si më doli nga mendja?! - tha vogëlushja.

Buzët që iu ngurosën, nuk arritën ta fshehin një dridhje të lehtë. Nuk e shihja dot ashtu.

- Ju kërkoj ndjesë për kohën e humbur, - vazhdoi Patricia.

Pastaj u kthye nga kafshët që kullosnin.

- Edhe sikur të iki, ne tani jemi miq, apo jo? - i thashë.

- Unë nuk kam asnjë mik. Edhe ju, si gjithë të tjerët jeni! - m'u përgjigj befas.

Të tjerët... kalimtarët, kureshtarët, indiferentët. Njerëzit e qyteteve të mëdhenj e të largët, që me veturat e tyre vinin e vidhnin një çast nga jeta e egër, pastaj iknin.

E ndjeva përsëri vetminë e vajzës.

- Nuk kam asnjë mik, - përsëriti Patricia.

Pastaj eci pa u ndier, me kujdesin më të madh, pa thyer asnjë degëz të brishtë.

Doli nga mbuloja e shkurreve dhe shkoi drejt lirishtës. Kokën e mbante pak të përkulur mbi supet e drejtuar përpara.

Pastaj silueta gri, me balluke të zeza, hyri në tapicerinë fërgëlluese të shkurnajave rrëzë Kilimanxharos.